



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 479 prot.

Tiranë, më 24.10 2019

VENDIM

Nr. 40, datë 24.10.2019

*Për miratimin e formës së diplomës për programin e studimit “Master i Shkencave” në
“Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja” në Fakultetin e Shkencave Sociale*

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 91; Udhëzimin Nr. 5, datë 18.02.2009 “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga LAL”, i ndryshuar, Udhëzimin e MASR-së Nr. 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, dhe Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma cc), Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 24.10.2019;

VENDOSI:

1. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Shkenca Politike-Integrimi dhe Qeverisja” në Fakultetin e Shkencave Sociale.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i përcillet për procedura të mëtejshme Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA).
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. MYNYR KONI

